



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E GAZETARËVE DHE OPERATORËVE TË TELEVISIONIT NEWS 24**  
**NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS**  
**30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

|         |           |            |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI -   | Kryetar    |
| Denar   | BIBA -    | Zv/Kryetar |
| Bledar  | SKËNDERI- | Anëtar     |
| Edlira  | JORGAQI-  | Anëtare    |
| Rezarta | BITRI-    | Anëtare    |

shqyrtoi gështjen me:

**OBJEKT:** Miratimi i gazetarëve dhe operatorë të paraqitur nga televizioni News 24 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Televizioni News 24 ka paraqitur kërkesën e tij me nr.Prot 12181 të datës 24.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 72 (shtatëdhjetë e dy) gazetarëve dhe operatorëve.

Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit nr.13 datë 22.04.2009 të KQZ "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare



shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave".

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e televizionit News 24, për akreditimin e 72 (shtatëdhjetë e dy) gazetarëve dhe operatorëve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

|                |                  |                   |
|----------------|------------------|-------------------|
| <b>Klement</b> | <b>ZGURI -</b>   | <b>Kryetar</b>    |
| <b>Denar</b>   | <b>BIBA -</b>    | <b>Zv/Kryetar</b> |
| <b>Bledar</b>  | <b>SKËNDERI-</b> | <b>Anëtar</b>     |
| <b>Edlira</b>  | <b>JORGAQI-</b>  | <b>Anëtare</b>    |
| <b>Rezarta</b> | <b>BITRI</b>     | <b>Anëtare</b>    |

